



VENDIM

Nr. 5, Datë 03/03/2015

Për një ndryshim të nenit 6 "Përbërja e Universitetit të Arteve", të Statutit të Universitetit të Arteve

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në Vendimin Nr. 1, të datës 29/01/2015, në zbatim të pikës 2, nenit 8, pika 2, gërma "d", nenit 14, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 5, nenit 6, si dhe pika 2, gërma "d", të nenit 9, të Statutit të Universitetit të Arteve, dhe Relacionit paraqitur nga Kryetari i Senatit, "Për një ndryshim të nenit 6 "Përbërja e Universitetit të Arteve", të Statutit të Universitetit të Arteve", Prof. Petrit Malaj,

konstatoj se:

Projekt-Vendimi, "Për një ndryshim të nenit 6 "Përbërja e Universitetit të Arteve", të Statutit të Universitetit të Arteve", paraqitur nga Rektori i Universitetit të Arteve, Prof. Petrit Malaj, është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Mbështetur edhe në diskutimet e anëtarëve të Senatit, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Ndryshimin e nenit 6, "**Përbërja e Universitetit të Arteve**", si më poshtë:
 - " 1. Universiteti i Arteve përbëhet nga Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.
 2. Rektorati organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të përcaktuara në këtë Statut.
 3. Fakulteti i Muzikës përbëhet nga:
 - a. Departamenti "Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore";
 - b. Departamenti "Interpretimit";
 - c. Departamenti "Kanto".
 4. Fakulteti i Artit skenik përbëhet nga:
 - a. Departamenti "Regji dhe Regji Filmi & TV";
 - b. Departamenti "Skenografi-Koreografi dhe Teori";
 - c. Departamenti "Aktrimit".
 5. Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga:
 - a. Departamenti "Pikturës";
 - b. Departamenti "Skulpturës";
 - c. Departamenti "Arteve të Aplikuara".



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

2. Ky vendim, në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i dërgohet MAS, për kontrollin e ligjshmërisë së këtij ndryshimi në Statutin e Universitetit të Arteve.

3. Vendimi të pasqyrohet në faqen zyrtare të UART;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Artan PEQINI

Prof. Gazmend LEKA

Prof. Milto KUTALI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Astrit SELITA

Miranda BAKIASI

Elia PLAKU ADEMI

Enisa VRENOZAJ

Albjan VUKA

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana Shuteriqi/Prela

Prof. Haig ZACHARIAN

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Ramazan GURRA

Kristina AGO